



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 3227 prot.

Ballsh, më 25.06.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 37, datë 25.06.2026

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR.11 DATË 28.02.2026”PËR DISA NDRYSHIME NË
VKB-NË NR.50, DATË 23.12.2025 ”PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË BASHKISË MALLAKASTËR, INSTITUCIONEVE NË VARËSI,
FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA DHE DELEGUARA PËR VITIN 2026, TË
NDRYSHUAR”**

KËSHILLIT TË BASHKISË


Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Vendimin nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar, VKM-së nr.75 datë 06.02.2026 “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut”.

PROPOZOJ:

- IV.** Një ndryshim , në VKB-në nr.11 datë 28.02.2026”Për disa ndryshime në VKB-në nr.50, datë 23.12.2025 ”Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, Institucioneve në varësi, Funksioneve të Transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar,
- V.** Ndryshimi konsiston në nivelin e pagave për funksionet e deleguara (Zyrat e gjendjeve Civile) lidhja nr.7 pjesë përbërse e këtij projektvendimi.
- VI.** Efektet financiare do të fillojnë nga data 01.04.2026.

KRYETAR

Qerim Ismailaj



Propozoj:

KRYETAR

Qerim Ismailaj



Niveli i pagave për funksionet e deleguara (Zyrat e gjendjeve Civile)

Lidhja nr. 7

Nr.	Emërtimi	Kategoria	Arsimi	Paga e grupit	Shtesë vjetërsie	Shtesë pozicioni
1.	Përgjegjës i zyrave të gjendjes civile (me arsim të lartë)	III-3,Vkm nr.325 datë 31.05.2023 e ndryshuar	I lartë	I	10 vjeçari parë 0,6%/vit 10 vjeçari dytë 0,8%/vit 10 vjeçari tretë 1%/vit	102000
2.	Specialist i zyrave të gjendjes civile	IV-3,Vkm nr.325 datë 31.05.2023 e ndryshuar	I lartë	1 ose 2,ose3	10 vjeçari parë 0,6%/vit 10 vjeçari dytë 0,8%/vit 10 vjeçari tretë 1%/vit	75000